



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 933 . Prot.

Tiranë, më 26 . 03 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 2198/17 PROT., DATË 19.12.2025 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË
ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASIT Z. SADIK BËRMETA DHE
ZNJ. HAJDIJE BËRMETA”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Sadik Bërmeta dhe znj. Hajdije Bërmeta, me nr. 2515 prot., datë 03.08.2023, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrates znj. A.P., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 2198/17 prot., datë 19.12.2025, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Sadik Bërmeta dhe znj. Hajdije Bërmeta”, bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e tyre. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesve, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesit mund të paraqesin ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesit, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Njësia Administrative Nr.2, Sauk, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

